
**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BPS Technology” Sh.p.k.**

Q.B. Q.M.S. A

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BPS Technology” Sh.p.k**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**BPS Technology**” Sh.p.k. qe ketu e tutje do te quhet “shoqeria”, dhe zoterohet nga ortaku:

1. **Enrico Piatti**, atesia Giovanni, shtetas italian, lindur me 25/02/1968 ne Bergamo, Italia, banues ne rruga Don E. Mazza 8D, 24020 Gorle, identifikuar nepermjet pasaportes Nr. YA6166101.
2. **Marco Santini**, atesia Sergio, shtetas italian, lindur me 16/10/1965 ne La Spezia, Italia, banues ne V.le della Vittoria 45, 19032 Lerici, identifikuar nepermjet pasaportes Nr. YB1987803.
3. **Gianpiero Beltrami**, atesia Giuseppe, shtetas italian, lindur me 26/08/1976 ne Sarnico, Italia, banues ne rruga Cesare Battisti 24, 25030 Cologne, identifikuar nepermjet pasaportes Nr. YB7617058

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “**BPS Technology**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI**

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale Sh.P.K., të cilat vijnë përparrë ose menjëherë pas emrit të shoqërise. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërise.

1.2 Emri i shoqërise është “**BPS Technology**” Sh.p.k. Forma dhe emri i shoqërise mund të ndryshohen me vendim të Asamblee së Pergjithshme të Ortakeve.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptare në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

Pag. 2 a 16

STATUTI “**BPS Technology**” Sh.p.k

*Q. B.
W. S. J.*

NENI 3 SELIA

Selia e shoqërise është në adresën: Brigada VIII, N23/H4, 1019 Tiranë.
Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të Asamblee së Ortakeve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqesi brenda territorit të Republikës së Shqipërise sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise. Zyrat, filialt ose përfaqesite e shoqërise jashtë territorit të Republikës së Shqipërise do të zhvillojne veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatese.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**BPS Technology**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie prodhimi dhe realizimi software dhe ka si objekt të veprimitarise së saj:

5.1 Konsulenca dhe projektimi për zgjidhje të problematikave në:

- zhvillim software dhe mbikeqyrja per sektore te industrise dhe tregtare;
- software aplikues, menaxhues dhe modelues;
- konsulence teknike dhe rregullat e sektorit te industrise;
- besueshmërinë e softwarit (testimi formal dhe operacional i softwarit);
- futja e teknologjive dixhitale.

5.2 Instalimi, asistenca, mirëmbajtja dhe monitorimi i rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të biznesit, si dhe software aplikativ.

5.3 Projektimi dhe instalimi i rrjeteve telematike.

5.4 Konceptimi, ndërtimi, publikimi dhe mirëmbajtja e faqeve web të shoqerive.

5.5 Organizimi, personalisht dhe / ose në emër të palëve të treta të konferencave, ekspozitave, demostrime të shoqerive dhe praktikave, kurseve të trajnimit etj.

5.6 Aktiviteti i sigurimit të përbajtjes dhe shpërndarjes së imazheve, ideve, teksteve dhe tingujve në Internet.

5.7 Tregtimi dhe dhënia me qira e software në përgjithësi në të gjitha format dhe aplikimet e tij, të pajisjeve hardware / elektronike dhe materialeve në përgjithësi, të

G.h. W.S. J

produkteve të informatikes, të rrjetit të telekomunikacionit, të produkteve apo procedurave për automatizimin industrial ose komercial, drejtpërdrejt ose tërthorazi të lidhur me sferën e informatikes, të hapësirave të reklamimit të përdorshme përmes sistemeve të informatike.

5.8 Tregtimi dhe dhënia me qira e shërbimeve të kontraktuara për aplikacionet, bazat e të dhënavë, sistemët, faqet e internetit, lidhshmëria telematike (hosting e housing), monitorimi i sigurisë, etj.

5.9 Kërkimi dhe zhvillimi i aplikacioneve të reja të ICT për çështje të ndryshme, si në emër të palëve të treta dhe për vete.

5.10 Aktivitet inkubacioni dhe fillimi i teknologjive të reja.

5.11 Përpunimi grafik përfshirë përpunimin e kartvizitave dhe stampave profesionale si dhe prodhimin dhe pas prodhimin e audio / video, fotografisë digitale, zhvillimin e grafikës dixhitale dhe animacionin.

5.12 Konsulence per marketing / komunikim / konsultim multimedial përfshirë edhe markat (branding), zhvillimin e planit te marketingut dhe komunikimit.

5.13 Projektimi dhe prodhimi i materialeve audiovizuale dhe spoteve reklamuese.

5.14 Shoqeria gjithashtu mund të kryejë, në përputhje me ligjin, të gjitha ato akte të dobishme ose të përshtatshme dhe gjykime ekskluzive të organit administrativ, për zbatimin e qëllimit të shoqerise, si për shembull:

- marrin pjesë në tenderë publikë dhe privatë;
- te jete pjesmarrese ne konsociume, ose bashkime edhe te perkohshme shoqerise;
- të marrë dhe të japë garanci, komisione, përfaqësime dhe mandate;
- të lëshojnë garanci në favor të palëve të treta;
- dhe në përgjithësi, në mënyrë dytësore dhe në mënyrë të rastësishme, kryejnë të gjitha transaksionet e tjera tregtare, industriale, të pasurive të patundshme, letrave me vlerë dhe financiare që organi administrativ e konsideron të nevojshëm, të dobishëm ose të përshtatshëm për zbatimin e qëllimeve shoqërore.

5.15 Tregtia, në çdo formë të pranuar, të produkteve dhe shërbimeve që lidhen me atë që ekspozohet, dhe në veçanti kompjuterët, printerët, aparatet telefonike dhe kopjimi, pajisjet e tij dhe të prodhimeve të konsumit; Tregti Elektronike (E-Commerce), dmth. biznesi i blerjes dhe shitjes së mallrave të konsumit, si me shumicë ashtu edhe me pakicë, të kryera nëpërmjet ndërmjetësve telematikë ndërmjet subjekteve fizikisht të largëta.

5.16 Organizim, mbajtje, koordinim i seminareve, takime, plane dhe kurse kolektive ose individuale, trajnim i stafit në fushën e informatikës (me përjashtim të ndërmjetësimit për vendosje ne pune).

5.17 Pjesëmarrja dhe përfaqësimi tregtare nga prodhuesit vendas ose të huaj edhe në ata sektore të krahasueshem me objektin themelor të shoqerisë.

5.18 Shoqeria mund të zhvilloje cdo tip operacioni tregtare, industrial, te pasurive te tundshme dhe të pasurive të patundshme lidhur me objektin shoqerore i konsideruar

*G. G.
M.S. N.*

nga organi administrativ i dobishëm për arritjen e objektivave shoqerore; mund të marre pjese drejtpërdrejt ose tërthortazi në fitimet e shoqerive te tjera.

5.19 Promovimi dhe pjesemarrja në mundesi të ndryshme investimi që mund të paraqiten në çdo sektor të ekonomise së vendit, duke u prezantuar si investitor i barabarte me subjekte të tretë, investitor i vetëm ose investitor mazhoritar me qëllim arritjen e objektivave ekonomike të shoqërise dhe pjesemarrjes në projektet me impakt social që diktojn rritjen ekonomike te vendit dhe standartet e tij të jetesës.

5.20 Shoqeria mund edhe të zhvilloje aktivitete shërbimesh, cdo lloj operacioni ose investimi në sektorin pasuri te tundshme, pasuri të patundshme, finanziare, tregtare, leshimin e miratimeve, garanci dhe koncesion të hipotekës, duke formuar, marrë pjesë ose duke u bashkuar në ndonjë formë në shoqëri të tjera duke pasur objektiva te ngjashem, të lidhura ose plotësuese me to.

NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E DISTINUARA PER TE TRETET

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise, administratoret si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i eksposojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojne lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

STATUTI "BPS Technology" Sh.p.k

Pag. 5 a 16

*Q.S.
A.S. J.*

NENI 9 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njeqindmije), i ndare në 3 (tre) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- Gianpiero Beltrami	34 %	-	34.000 LEKE
2- Marco Santini	33 %	-	33.000 LEKE
3- Enrico Piatti	33 %	-	33.000 LEKE

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 10 **TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN**

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcione kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi.

Nese ndonjeri nga ortaket nuk do te nenshkruej kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e drejta e opcionit do ti perkase ortakeve te tjere.

Duke mos e ushtruar ortakët të drejtë e opcionit, kapitali në zmadhim i panënskruar do te nënskruhet nga palë të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbrushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbarimore ose ndonjë organ tjeter kompetent), duhet të ketë në konsiderate respektimin e kërkeseve të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje neni 13 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcione kuotat e pjesemarrjes ne kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojne dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11 **FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT**

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do te kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gjeson ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12 **FINANCIMI I SHOQERISE**

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkoje nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpermjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13 **TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT**

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakeve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjisacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

13.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

- Oferta per shitje u drejtohet te gjithe ortakeve me shkrim;
- Oferta duhet te percaktoje numrin e kuotave qe shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortaket e shoqerise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojne blerjen e kuotave te ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojne shitblerjen tek te tretet.

13.3 Kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashigimie. Bashkshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet trasferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

13.4 Klauzolë miratimi. Nëse asnje ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes ne kohe dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejten e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese se Ortakeve që vendos për pranimin e trasferimit te një person i tretë.

Ortaket mblidhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) dite, nëpermjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vodusur me votën pro (ne favor) me të paktën gjysmen e kapitalit themeltar.

13.5 Pelqimi mund te refuzohet vetem kur bleresi nuk jep garanci te mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqeria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo te ortakevete te tjerë.

Asambleja e Ortakeve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

*Q.B.
W.S. M*

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues qe nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhene dhe ortaket mund të transferojne kuoten e tyre.

13.6 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me te përshtatshem.

KAPITULLI V **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

NENI 14 **ORGANET DREJTUESE**

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emeroje më shume se një Administrator. Ne çdo rast, kur termi "Administrator" perdoret per te percaktuar Administratorin e shoqerise "**BPS Technology**" Sh.p.k., ky term nenkupton te gjithe Administratoret e saj sado qofshin keta ne numer.

14.3 Perveç organeve te parashikuara me siper Asambleja e Ortakeve mund te krijoje edhe organe te tjera drejtuese, ne aktet e krijimit te ketyre organeve do te percaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqërise për një periudhë 3 (tre) vjeçare deri me 31/12/2023 është emeruar Z.nja **Eriselda Pjetri** lindur ne Fier ne 27/07/1985 rezidente ne Tirane, identifikuar nga Karta Identitetit Nr. I55727046C.

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

NENI 15 **VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE**

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos per çeshtjet qe ligji apo ky statut i rezervon ketij organi, si dhe per çeshtjet per te cilat, organi administrativ kerkon mendimin apo miratimin e ortakeve.

15.2 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asamblea e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese

G. B. M.S.

ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Ne rastin kur Asambleja e Ortakeve duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqerite tregtare, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 75 % te numrit total te kuotave te kapitalit themeltar jane te pranishem dhe vendosin me voten e $\frac{3}{4}$ (tre te katertave).

NENI 16 **KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE**

16.1 Ne perputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund te merren pas nje konsultimi me shkrim qe organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Ne kete rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

16.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky statut kerkon per ate çeshtje.

NENI 17 **MENYRA DHE VENDI I THIRRJES** **I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda ose jashte Republikes se Shqiperise, edhe përmes modalitetit online, nepermjet nje njoftimi me shkrim nepermjet postes elektronike (E-mail), qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organit Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esperti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18 **KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

18.3 Kryetari i pare i Asamblese se ortakeve eshte zgjedhur Z.nja Eriselda Pjetri.

NENI 19 **PJESEMARRJA NE VENDIME**

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatori duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejtat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesaruve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.

- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividentit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Perveç kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizoje Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

20.6 Ortakët e Shoqërisë Enrico Piatti, Marco Santini dhe Gianpiero Beltrami mund të veprojnë dhe zëvendësojnë administratorin e shoqerisë dhe të percaktojnë transaksione të çdo natyre individualisht dhe në mënyrë të pavarur pa asnë kufi.

20.7 Ortaket e Shoqerise Enrico Piatti, Marco Santini dhe Gianpiero Beltrami mund te veprojne individualisht dhe në mënyrë të pavarur për kompetencat e mëposhtme:

- të drejtën për të përfaqësuar shoqerinë në çdo institucion shtetëror ose privat pa kufizime për të bërë të gjitha deklaratat ose regjistimet e detyrueshme ose vullnetare sipas legjislacionit të aplikueshëm shqiptar, për shembull, zyrat tatimore - pagesa tatimore, sigurimet shoqërore, zyra ose agjencitë doganore, Qendra Kombëtare e Licencimit dhe / ose Qendra Kombëtare e Biznesit, zyra e punësimit, pagesa e pagave etj., të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e zakonshme të shoqërise.

- përfaqësim në çdo bankë të nivelit të dytë që vepron në Shqipëri ku shoqeria ka llogari rrjedhëse ose para ndonjë institucioni shtetëror, për pagesat e taksave, kontributet e sigurimeve shoqërore, tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi të ardhurat, tatimin në burim, taksat lokale, pagat e punonjësve, pagesa e qirasë etj. dhe çdo detyrim të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, i cili në çdo rast duhet të bëhet me transfertat bankare nga llogaritë ekzistuese të shoqerisë tek këto institucione.

- menaxhimin e zakonshëm të punonjësve dhe mbikëqyrjen e tyre duke përfshirë mbikëqyrjen e aktivitetit të tyre, hartimin e kontratave të punës.

NENI 21

ADMINISTRATORET DHE KOMPETENCAT E TYRE

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjesë te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.

- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoquerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoquerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithe sebashku ose vecmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoquerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoquerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.


21.3 Administratori ose Administratoret nuk jane pergjegjes ndaj shoquerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar posicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem, edhe nga cfare parashikohet ne neni 7 i ketij statuti.

21.4 Shoqeria mund te administrohet nga një administrator i vetem ose nga shume administratore, nga dy deri ne nente anetar, sipas krijimit nga akti i emertimit. Ne rastin e shume administratoreve, ata mund te formojne një trup kolektiv, keshilli i administrimit, ose një trup jo kolektiv, anetaret e te cilit mund te veprojne ne ane te perbashketa, te ndara, ose te miksuara ne baze te asaj qe do te krijohet nga akti i emertimit.

21.5 Nuk mund te emertohet administrator ose perfaquesues dhe, nese emertohet, bie nga zyra e tij, ndalohet, i paafti, deshtuesi ose kush eshte denuar me një denim, edhe perkohesisht, nga zyrat publike ose paaftesia ne ushtrimin e zyrave ekzekutive.

21.6 Administratoret kane te gjithe kompetencat e drejtimit te zakonshem te shoquerise per zbatimin e qellimit te saj, pervec kompetences se dhene nga vendimi i ortakeve ne perputhje me ligjin. Cdo administrator ose perfaquesues mund te heqi dore ne cdo moment, duke derguar një njoftim me poste rekomande ose nepermjet një njoftimi me shkrim nepermjet postes elektronike (E-mail) tek administratoret e tjere, ne rastin e shume administratoreve, dhe cdo ortakeve. Doreheqja ka efekt te menjehersh hem nese mbetet ne detyre shumica e administratoreve ose perfaquesuesve. Ne rast te kundert, ajo ka efekt nga momenti qe emerohet administratori ose perfaquesuesi i ri, vetem nese, te mbetet te pakten një administrator ose perfaquesues, doreheqja do te pranohet me shkrim nga ana e cdo ortaku tjeter, ne kete rast, komunikimi i administratorit qe jep doreheqjen nderpritet menjehere.

21.7 Cdo administrator ose perfaquesues pushohet nga detyra per skadencen e afatit te themeluar nga akti i emertimit, ne vdekje, per paraqitjen e situatave qe sjellin padrejtesi ose papajtueshmeri per detyren, qoft kjo edhe pa shkak, me vendim te ortakeve. Ne kete rast, nnderprerja e kontrates verifikohet kur vendimi per terheqje, i eshte njoftuar nepermjet postes ose me dore administratorit ose perfaquesuesit te



revokuar. Revokimi, ne mungese te nje shkaku, nuk sjell asnje te drejte per te kompesuar demet.

21.8 Keshilli i Administrimit. Keshill administrimit perbehet nga nje numer anetaresh i vendosur nga akti i emertimit, nga te cilet eshte zgjedhur presidenti dhe zevendes presidenti, nese nuk eshte bere nga vendimi i ortakeve. Keshilli i administrimit, mbledh si ne zyren qendore ashtu edhe tjeterkund, sa here e gjykon te nevojshme, te pakten nje keshilltar ose, nese eshte emeruar, kryetari i komunes ose auditori.

Procedura ne mbledhjet e keshillit mund edhe te behet nepermjet mjeteve te telekomunikimit, me kushtin qe te gjithe pjesemarresit mund te identifikohen dhe ti lejohet qe te ndjekin diskutimet, te marrin, te transmetojne ose te shohin dokumente, te nderhyjne duke folur ne kohe reale mbi te gjitha argumentet. Per vlefshmerine e vendimeve te keshillit duhet te jene te pranishem dhe me vota te favorshme nga shumica e anetareve.

Vendimet e administratorit mund edhe te jene te miratuara nga konsultimet me shkrim, ose pelqimin e shprehur me shkrim te derguara me telegram, telefaks ose e-mail brenda periudhes se specifikuar ne kerkese. Ne kete rast aplikohen te gjitha dispozitat e diktuar lidhur me vendimet e ortakeve nga paktet sociale prezente.

Brenda kufijve ligjore, keshilli i administrimit mund te delegoje fuqine e tij, te gjithen ose nje pjese , tek nje ose disa anetareve te tij.

21.9 Administratori Eriselda Pjetri ka vetem kompetencat e mëposhtme:

- të drejtën për të përfaqësuar shoqerinë në çdo institucion shtetëror ose privat pa kufizime për të bërë të gjitha deklaratat ose regjistrimet e detyrueshme ose vullnetare sipas legjislacionit të aplikueshëm shqiptar, për shembull, zyrat tatimore - pagesa tatimore, sigurimet shoqërore, zyra ose agjencitë doganore, Qendra Kombëtare e Licencimit dhe / ose Qendra Kombëtare e Biznesit, zyra e punësimit, pagesa e pagave etj., të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e zakonshme të kompanisë.
- përfaqësim në çdo bankë të nivelit të dytë që vepron në Shqipëri ku shoqeria ka llogari rrjedhëse ose para ndonjë institucioni shtetëror, për pagesat e taksave, kontributet e sigurimeve shoqërore, tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi të ardhurat, tatimin në burim, taksat komunale, pagesën pagat e punonjësve, pagesa e qirasë etj. dhe çdo detyrim të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, i cili në çdo rast duhet të bëhet me transfertat bankare nga llogaritë ekzistuese të kontrollit të shoqerisë tek këto institucione.
- administratori nuk ka kompetencia për të hapur pozicione të reja financiare, llogari rrjedhëse, linja krediti, etj. përvçeç nëse me autorizim / vendim paraprake të Asembleësë të Ortakëve.

KAPITULLI VII
KONTROLI KONTABEL,
BILANCI, DIVIDENTET

NENI 22 KONTROLLI KONTABEL

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeroje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23 BILANCI DHE REZERVAT

23.1 Bilanci mbylljet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.


KAPITULLI VIII MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE, LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 24 MBARIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 25 LIKUJDIMI

25.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i



paraqesin asaj reportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

25.2 Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e proçesit te likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shperndahet ortakeve.

NENI 26 **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dërgohen shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemer të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërise. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nentdhjete) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërise. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët.

Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedures se largimit të ortakut, dhe t'i ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërine për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjete) ditëve nga marrja e komunikimit nga shoqeria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakeve ne baze te kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nese nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atehere shoqëria vendoset në likujdim.

26.4 Përjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likujdimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likujdimin e mundshëm të shoqërisë.

Përjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX **MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT**

NENI 27 **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Çdo mosmarreveshje a konflikt ne lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kesaj shoqerie, ortaket do te angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder.

NENI 28 **DISPOZITA TE FUNDIT**

28.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptare ne fushen e shoqerive tregtare si dhe legjislacioni shqiptare ne per gjithsi.


28.2 Shoqeria do kete vulen, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhesite do te percaktohen nga asambleja e ortakeve ne veçanti dhe me propozim te administratorit.


28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 8 (tete) ekzemplare, 4 (kater) ne gjuhen shqipe dhe 4 (kater) ne gjuhen italiane, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Tirane, 27 / 09 / 2021

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“BPS Technology” Sh.p.k.**

Enrico Piatti


Gianpiero Beltrami

G.B.

Marco Santini

M.S.
W.S.